

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Njesia orga	Num	Nr Ekzempl	Vlera
	2537		

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	478/1		



UNIVERSITETI / UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, duke u bazuar në nenin 72 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, nenit 9 të Rregullores nr. Prot. 1670, dt. 28.09.2021 për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 22 pika 1 të Rregullores mbi zgjedhjet në Universitetin e Mitrovicës dhe punën e Këshillit të Fakultetit, më datë 25.10.2022 merr këtë:

VENDIM

- I. Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore në mbledhjen e mbajtur me datë 25.10.2022 ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e komisionit të ankesave dhe parashtrësive, të emëruar nga Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, sipas konkursit të shpallur, nr. Prot. 2046 të datës 14.09.2022 të UIBM-së, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njëjësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
- II. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e parashtrueses Gonxhe Kajtazi, me numër protokoli 446 e dates 19.10.2022, kundër përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm nga komisioni vlerësues, për pozitën **Një asistent për lëndët: Bazat e inxhinierisë së bioproceseve; Ekologjia në industrinë ushqimore; Inxhinieria e proceseve ushqimore; Kontrollimi i cilësisë së ushqimit; Teknologjia e mishit.**

Arsyetim

Komisioni vlerësues ka bërë përzgjedhjen e Arbnora Durmishaj si kandidat i suksesshëm për pozitën një asistent për lëndët e lartëcekura. Parashtruesja e ankesës duke shfrytëzuar mjetet juridike, brenda afateve ligjore ka ankimuar propozimin e komisionit vlerësues. Komisioni i ankesave dhe parashtrësive, pas shqyrtimit dhe analizës së pretendimeve të parashtrueses ka gjetur se pretendimet e parashtrueses nuk qëndrojnë dhe janë të pa baza. Parashtruesja është thirrur në faktin se ajo ka notën mesatare më të lartë se të kandidatës së përzgjedhur mirëpo askund nuk ceket se nota

mesatare e determinon përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm. Komisioni vlerësues ka vlerësuar se numrin më të madh të kriterëve e ka përmbushur kandidatja e përzgjedhur dhe se qëndrojnë prapa vendimit të tyre edhe pas ankesës së parashtrueses.

Bazuar në gjetjet e komisionit të ankesave dhe parashtrësive, Këshilli i Fakultetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bashkëngjitur gjeni raportin e komisionit të ankesave dhe parashtrësive.

I dorëzohet:

Zyrës për çështje akademike

Arkivit të fakultetit

Kryesuesi i Këshillit të Fakultetit



Prof. Asoc. Dr. Milaim Sadiku



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI

Pranuar me dt. 26.10.2022			
Njesia orga	Num	Nr. Ekzam	Vlera
	2537/1		

Nr. Prot. 473/1 Dt. 21.10.2022

Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, pas mbajtjes së mbledhjes të datës 21.10.2022, për shqyrtimin e ankesës të kandidatës Gonxhe Kajtazi (tani e tutje parashtruesja), ndaj procedurave për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime, në kolegji nxjerr këtë:

RAPORT

I. **REFUZOHET** e pa bazuar ankesa e parashtrueses, kunder përzgjedhjes për kandidatin e suksesshëm nga komisioni vlerësues.

I. Rrethanat e rastit

Me 14.09.2022, Universiteti "Isa Boletini në Mitrovicë ka shpallur konkurs nr. Prot. 2046, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime.

Më 20.09.2022, Këshilli i Fakultetit i Teknologjisë Ushqimore (Këtu e tutje: Këshilli i Fakultetit) caktoi Komisionin vlerësues.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/515516 – lokali 3



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Me 04.10.2022, komisioni vlerësues përpiloi raportin vlerësues (nr.Prot. 441).

Me 11.10.2022, është publikuar raporti i komisionit vlerësues në Buletin.

Me 19.10.2022, parashtruesja ka paraqitur ankesë (Nr. Prot.473/1) në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (Këtu e tutje: Komisioni i Ankesave) kundër raportit të komisionit vlerësues sipas Buletinit të publikuar me 11.10.2022).

Më 21.10.2022, Komisioni i Ankesave dhe parashtrësive shkroi Raport (Nr. Prot. 365), me të cilin konstatoj të pa bazuar ankesën e parashtrueses, Gonxhe Kajtazi, përkatësisht duke respektuar Raportin e Komisioni Vlerësues për kandidatin e suksesshëm, Arbnora Durmishaj të zgjedhet asistente bashkëpunëtore e jashtme për ushtrime në lëndët: Inxhiniëria e proceseve ushqimore; Bazat e inxhinierisë së bioproceseve; Ekologjia në industrinë ushqimore; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; Kontrollimi i cilësisë së u shqimit dhe Teknologjia e mishit.

II. Pretendimet e parashtrueses

Duke pasur parasysh se unë Gonxhe Kajtazi, kam qenë e angazhuar si asistente bashkëpunëtore që nga data 01.12.2021 deri me datë 31.05.2022 si dhe marrë parasysh faktin se i kam plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe të përcaktuar në këtë konkurs, si kandidat potenciale për tu pranuar në këtë pozitë të punës, kam aplikuar në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023, më numër 2046, të datës 14.09.2022, për pozitën, një asistent për lëndët: Inxhiniëria e proceseve ushqimore; Bazat e inxhinierisë së bioproceseve; Ekologjia në industrinë ushqimore; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; Kontrollimi i cilësisë së u shqimit dhe Teknologjia e mishit.

Komisioni Pranuar për shqyrtimin e aplikacioneve për këtë pozitë të punës, datën 11.10.2022 ka shpallur rezultatet e pranimit nga konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023, ku ka përcaktuar si kandidat e cila ka plotësuar kushtet e konkursit, njëren nga kandidatet e tjera.

Në Rregulloren me numër 1670, të datës 28.09.2021, për procedurat vlersuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" Mitrovicë, siç ceket edhe në konkursin me numër 2046, të datës 14.09.2022, janë të mirëpërcaktuara kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM, sikurse më poshtë:

1. Të kënë të përfunduar studimet master ose ekuivalente me të në lëmin përkatëse.
2. Të kënë notën mesatare jo më të vogël së 8 në të dy nivelet e studimit.
3. Të jëtë jo më i vjetër së 30 vjet kur angazhohet për herë të parë.
4. Kandidati më doktoraturë të përfunduar ka përparësi në raport me kandidatët e tjerë.

Në konkursin ë vitit të kaluar për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2021/2022, më numër 649, të datës 01.11.2021, në konkurrëncë me po të njëjtën kandidatë (e propozuar



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

nga Komisioni Vlerësues tani si asistente bashkëpunëtoresh për vitin akademik 2022/2023) jam përzgjedhur si asistente bashkëpunëtoresh pikërisht duke u bazuar në notën më të lartë mesatare në dy nivelet e studimit (që marrë parasysh faktin se për këtë pozitë të punës nuk i nënshtrohem testimeve vlerësuese, kjo paraqet bazën kryesore për tu pranuar në këtë pozitë të punës), konstatim ky i bërë duke u bazuar në rregulloren më numër 1670, të datës 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.

Por, në konkursin e tanishëm, për vitin akademik 2022/2023 me numër 2046, të datës 14.09.2022, me po të njëjtën kandidatë sikurse në konkursin e vitit të kaluar me të njëjtat kriteret të konkursit, unë nuk jam përzgjedhur si asistente bashkëpunëtoresh, duke u shkelur kështu kushtet për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm sipas rregullores me numër 1670, të datës 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM siç ceket edhe në dy konkurset (nota më e lartë në të dy nivelet e studimit), shkelje kjo e bërë nga vetë anëtarët e Komisionit Vlerësues, gjë që kjo paraqet vlerësim të gabuar dhe jo të saktë lidhur me pranimin e kandidatit adekuat për pozitën e punës, dhe në këtë formë duke m'i mohuar të drejtat e mia, si kandidatë e cila i ka plotësuar kushtet dhe kriteret në masë më të madhe se kundër kandidatja e pranuar.

Gjithashtu, në bazë të vendim-propozimit të propozuar nga Komisioni Vlerësues cekët se: "Kandidatja në CV deklaron se ka qenë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara "Van Hall Larenstein", Leeuwarden, Holandë, mirëpo nuk ofron dëshmi", gjë që ky konstatim i komisionit vlerësues, ka qenë i gabuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e bashkangjitur në konkurs, kjo pasi që në dokumentet e dorëzuar fizikisht si dhe në dokumentet e dërguara në formë elektronike, i'u është bashkangjitur edhe certifikata e notave nga kompletimi i lëndëve të realizuar në këtë mobilitet, e kjo njëkohësisht dëshmon edhe njohjen e gjuhës angleze nga ana ime, meqenëse mobiliteti është realizuar në gjuhën angleze, ku kjo paraqet edhe përparësi edhe nga ana ime për këtë pozitë të punës.

Por që komisioni vlerësues nuk i ka marrë fare parasysh këto kushte të konkursit, përparësi të cilat i kam plotësuar në mënyrë absolute, duke rezultuar në mos vlerësim në mënyrën e duhur të përgaditjeve shkollorë-universitare.

Gjithashtu së bashku me dokumentacionin e dërguar (në formë fizike dhe elektronike) për aplikim në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023 me numër protokollit 2046, të datës 14.09.2022, është dorëzuar edhe një dëshmi që do të marr pjesë në një Konferencë Shkencore në Tiranë dy ditë pasi do jetë mbyllur afati për aplikim në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm 2022/2023, dhe meqenëse se ende nuk kam pasur dëshmi-certifikatë të pjesëmarrjes, si dëshmi është dërguar një e-mail ku Redaktori i Konferencës njofton që abstrakti im është pranuar për tu prezantur në Konferencën Shkencore që do mbahej në datën 30.09.2022-02.10.2022.

Por që komisioni vlerësues prapë nuk e ka marrë fare parasysh edhe këtë përparësi të konkursit, duke mos e paraqitur fare në tabelën vlerësuese nga Raporti i Komisionit Vlerësues.

III. Meritat e rastit

Gjatë leximit përkatësisht vlerësimit të raportit të Komisionit Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për vitin akademik 2022/2023, me nr. Prot. 2046 të datës 14.09.2022, për pozitën Asistent në lëndët: Inxhinieria e proceseve ushqimore; Bazat e inxhinierisë së bioproceseve; Ekologjia në industrinë ushqimore; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; Kontrollimi i



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

sipas pikës 11/9 të konkursit për bashkëpunëtorë, i publikuar në faqen zyrtare të Universitetit me datën 11.10.2022 dhe numër protokoli 2341/6.

Raporti i dërgohet:

Kryetare e Komisionit: Prof. Asoc. Dr. Besire Cena

Arkivit të Fakultetit;

Të përmenduarit/es;

Anëtare e Komisionit: Dr. Sc. Malësore Pllana *M. Pllana*

Anëtar i Komisionit: Arbër Hyseni *A. Hyseni*

1.

2.

21.10.2022

Mitrovice